



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 139/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Deçan, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçan, për shkak të vendosjes së posterave në vendet publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), dega në Deçan, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçan i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 800 (tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 03.10.2013 subjekti politik LVV dega në Deçan ka parashtruar ankesë në PZAP me të cilën pretendon se anëtarë të subjektit politik AAK, me datën 03.10.2013 rreth orës 14:45 në pallatin e kulturës “Jusuf Gërvalla” kanë vendosur posterat e kandidatit për kryetar komune nga subjekti politik AAK Rasim Selmanaj. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2009, dhe Ligji për zgjedhjet e përgjithshme. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 04.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.10.2012, në ora 12:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK në të cilën deklaroi se vendosja e posterave në objektin publik nuk është vendosur në mënyrë të qëllimshme apo të organizuar nga strukturat menaxhuese të AAK-së por ato mund të jenë bërë nga individ të pa identifikuar, dhe se strukturat e AAK-së në Deçan me të njoftuar me ankesën në fjalë kanë bërë largimin e këtyre posterave.

Andaj si dëshmi përgjigjes në ankesë subjekti politik AAK i kanë bashkangjitur: udhëzimin e kryetarit të AAK-së drejtuar strukturave të AAK-së për respektimin e

ligjit për zgjedhje dhe rregullat zgjedhore, fotografimin në të cilat dëshmohet veprimi i largimit të posterave të vendosura dhe kërkesën drejtuar shefave të shtabeve zgjedhore për respektim të kodit zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatit për kryetar komune të Deçanit Rasim Selmanaj nga radhët e subjektit politik AAK janë të vendosura në pallatin e kulturës “Jusuf Gërvalla”, e që është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 13/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë godinave dhe objekteve publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik AAK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, po ashtu edhe faktin se posterat e kandidatit për kryetar komune në Deçan kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë fotografimin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik AAK është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit të AAK-së janë vendosur në objekt publik, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik AAK për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, prandaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) dhe 115.1 të LZP-së, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 139/2013 më datën 05.10.2013.

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*